



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 296/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, në seancën e panelit të mbajtur me 12.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), në Prishtinë kështu që subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në Prishtinë, i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 1050 (njëmijë e pesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi

Arsyetim

PZAP-i, më datë 09.06.2014 ka pranuar një ankesë, nga Lëvizja Vetëvendosje në Prishtinë, në të cilën theksohet se me datën 08.06.2014 në ora 07:16, në fakultetin filologjik në vendvotimin nr.1906 E, është parkuar një veturë e llojit golf 5 me ngjyrë silver dhe ka qëndruar një kohë të gjatë në hyrje të Qendrës së Votimit me logon “Misioni i Ri”. Me këtë rast parashtruesi i ankesës konsideron se është bërë shkelje e dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës përkatësisht neni 36, Rregullën Zgjedhore Nr 11/2013 Kodi i Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët, neni 7; Rregullën Zgjedhore Nr.09/2013, Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Qendrës së Votimit neni 12.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si dëshmi foto nga vendi i supozuar i ngjarjes.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4,paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, me datë 08.06.2014 e informoi subjektin politik PDK, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik nga AKR dhe ka kërkuar që të përgjigjet në ankesë, deri më date 09.06.2014 në ora 17.00.

Sipas afatit të caktuar, PZAP-i, mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik PDK në të cilën deklaroi se në vendvotimin me nr. 1906 E, vetura në fjalë ka shkuar në këtë qendër mirëpo nuk ka qëndruar ashtu siç pretendon Lëvizja Vetëvendosjes se vetura është parkuar dhe ka qëndruar gjatë dhe nëse ka qëndruar ashtu siç pretendon LVV, përgjegjësia letë mbetet tek menaxheri i qendrës.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Në fotografinë e ofruar si provë që gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se në Fakultetin Filologjik në qendrën e votimit ka qëndruar vetura me logon “Misioni i Ri” në ditën e zgjedhjeve me 08 qershor, duke thyer heshtjen zgjedhore.

Andaj PZAP-i duke marr parasysh se subjekti politik i lartpërmendur, ka bërë thyerje të heshtjes zgjedhore në mënyrën e lartpërmendur, duke përsëritur dy herë radhazi shkeljen e njëjtë, dhe se përsëritja disa herë e të njëjtës shkelje patjetër ndikon në lartësinë e gjobës. Andaj PZAP-i në mbështetje të dispozitave ligjore të LZP-së konstaton se subjekti politik PDK është përgjegjëse për veprimet e saja duke shkelur nenin 36 paragrafi 1 pika b) e LZP-së, që përcakton veprimet e ndaluara para procesit të votimit dhe bërja fushatë në çfarëdo mënyre ku thuhet se 24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja fushatë në çfarëdo mënyre, veprime këto që e bëjnë përgjegjëse dhe kanë ndikuar në caktimin e lartësisë së gjobës së shqiptuar, në kuptim të nenit 36.1 pika a) dhe nenit 120 paragrafi 1 pika c), lidhur me nenin 118.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 296/2014 më datën 12.06.2014

**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**



Këshillë Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore*